

Të nxënët e kombinuar (blended learning)



Gerda SULA

Kush thotë që mësimi i kombinuar është i vështirë?




Unë jam 39 vjeç dhe ndihem shkëlqyeshëm!

Çfarë është të nxënët e kombinuar?

- Ndryshe dhe mësimi hibrid
- Një kombinim i mësimdhënies dhe të nxënët në klasë me ato online, që ofron qasje në mundësi të nxënët më të mëdha për zhvillimin e aftësive dhe ekspertizës së nxënësve (U.S. Department of Education (Means, Toyama, Murphy, Bakia, & Jones, 2009, Cleveland-Innes, 2017)).
- Shkrirje e menduar mirë e përvojave të të nxënët ballë për ballë me ato online (Garrison & Vaughan, 2008)


Modelet e të nxënit të kombinuar



Klasa e përmbysur	Blended	Online
Mësim në klasë e kombinuar me burime online, psh: - Video të shkurtra, teknika përpara mësimit - Mësim në klasë për ndërveprim dhe punë me grupe	Kombinim i: - Mësimint intensiv në klasë në 1 ditë apo 1 javë - Veprimtari dhe ndërveprim online - Përmbajtje dhe burime online	Kombinim i: - Video të shkurtra me burime dhe veprimtari mësimore online - Tutoriale online (sinkron) - Ndërveprim ndërmjet bashkëpunimit, forumeve të diskutimit dhe punës në grup online


Përshkruani

- Përshkruani përvojën tuaj me mësimin e kombinuar
- Në mënyrë objektive, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:
 - Çfarë bëtë?
 - Përse e bëtë atë?
 - Cili ishte avantazhi sipas jush i këtij modeli?
 - Çfarë ndodhi si rezultat i këtij modeli?
 - Si ishte vazhdimi i lëndës?
 - Cilat ishin gjërat më unike që ndodhën gjatë mësimit?




Përfitimet nga mësimi i kombinuar

- Mundësi për bashkëpunim në distancë
- Fleksibilitet i rritur
- Ndërveprim i shtuar
- Përmirësim i të nxënit
- Qytetarë digjitalë



Çfarë na duhet?

- Akses në teknologji
- Planifikimi i kujdesshëm
- Siguri
- Zhvillimi i aftësive, suporti dhe trajnimi
- Motivimi



Çfarë na duhet për një mësim të suksesshëm!



Mendësia është kyç!

Fokusohu tek aftësitë




Ji i qëllimshëm

Bashkëpunohet



Sinkron dhe asinkron: Thyej rutinën
gjej balancën



Sill zëra të rinj

Zgjidh veprimtari që i
përshtaten RM



Nxënësit janë në
qendër

Ji njerëzor!



Ekzaminoni

- Mbani një qëndrim kritik gjatë mësimdhënies së kombinuar
- Në mënyrë objektive, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:
 - A ndodhi ndonjë gjë që nuk e prisnit? Çfarë?
 - A mendoni se këto ishin të rëndësishme në të nxënët e nxënësve? Përse?
 - Si reagues nxënësit ndaj mësimit të kombinuar?
 - Çfarë mund të kishit bërë ndryshe?
 - Çfarë sfidash ju dolën dhe si u përpoqët t'i zgjidhnit?

Çështje për reflektim

- Si është aksesimi në teknologji për nxënësit tuaj?
- Si janë aftësitë teknologjike të nxënësve tuaj? Tuajat?
- A keni nevojë për mbështetje në teknologji? Ku mund ta gjeni këtë mbështetje?
- Çfarë rrugësh përdorni për të vendosur cilat veprimtari do t'i ofroni ballë për ballë e cilat online?
- Cila është përvoja juaj me mësimin e kombinuar?



Zëvendësim	Shtim	Modifikim	Ripërkufizim
Teknologjia përdoret njësoj si materialet klasike në klasë. (detyra në word)	Teknologjia shton një dimension që nuk është në materialet klasike (psh. Një kuic)	Modifikim i materialeve klasike për të ndryshuar funksionin e mësimin (psh nxënësit përgatisin video).	Përdorimi i teknologjisë është një veprimtari mësimore e re. (psh Wikis për të hartuar një detyrë në bashkëpunim).

Për të patur një mësim të kombinuar efektiv

- Katër hapa:

1. Fokusohu tek pedagogjia dhe identifiko modelin e mësimdhënies në situatën tënde specifike
2. Zgjidh me kujdes teknologjinë
3. Kini parasysh kurrikulën
4. Mendoni për llogaridhënien

- Cilët mendoni se janë faktorët më të rëndësishëm që duhet të kini parasysh kur planifikoni për mësim të kombinuar të lëndës suaj?

Kombinimi i veprimtarive të të nxënit dhe ndërveprimi

	Në klasë	online
Bashkëveprimi me mësuesin	Lehtësimi Mësimdhënia e drejtpërdrejtë	Lehtësimi Mësimdhënia e drejtpërdrejtë
Bashkëveprimi me shokët	Komunikim i hapur Shprehja e emocioneve Kohezioni i grupit	Komunikim i hapur Shprehja e emocioneve Kohezioni i grupit
Bashkëveprimi me përmbajtjen	Ngjarja ngacmuese Eksplorimi i njohurisë së re Integrimi i aftësive Praktikimi i aftësive të mësuara	Ngjarja ngacmuese Eksplorimi i njohurisë së re Integrimi i aftësive Praktikimi i aftësive të mësuara

Avantazhet dhe sfidat

Avantazhet	Sfidat
- Mundësi për të nxënë bashkëpunës - Përmirësim në akses - Përmirësim në komunikim - Strategjitë e vlerësimit	- Nevoja për teknologji - Njohuritë dhe aftësitë IT - Mungesë e motivimit të brendshëm dhe e vetëdrejtimit nga ana e nxënësve

Rezultatet e të nxënit të kurrikulës


RM/Objektivat/Rezultatet e të nxënit janë të paracaktuara. Mbi këto hartohen kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit

Pasi përcaktohen kriteret e vlerësimit, hartohen veprimtaritë mësimore që do t'u mësojnë nxënësve si të arrijnë kriteret e vlerësimit (e si rrjedhojë, rezultatet e të nxënit.)

Veprimtaritë e mësimdhënies dhe të nxënit

Ajo që bëjnë mësuesi dhe nxënësit duke synuar të arrijnë rezultatet nëpërmjet plotësimit kriteret e vlerësimit. Kjo shfrytëzon tendencën e nxënësve për të mësuar atë që ata mendojnë se do të vlerësohet



Reflektim

- Kur konsideroni lëndën, nxënësit dhe veprimtaritë mësimore, a mund të identifikoni nxitës dhe pengesa të mundshme për mësimin e kombinuar?
- Si mund t'i përdorni RM/Objektivat/Rezultatet e të nxënit kur planifikoni për mësim të kombinuar?
- Çfarë strategjish vlerësimi përdoni dhe si kanë ndryshuar ato gjatë mësimin të kombinuar?

Teknologjitë e mundshme

- LMS (Learning Management System)
- Mësimi sinkron (psh ZOOM)
- Tekstet mësimore digjitale
- Blogs dhe Wikis
- Digital storytelling (psh storybird)
- Simulime (si Geogebra), laboratore virtuale
- Gamification (minecraft, Kahoot)
- E-portfolio



Kombinimi i mësimet sinkron me asinkron

	Përfitimet	Vështirësitë
Sinkron	- Diskutimet dhe bashkëpunimi në kohë reale - Feedback i menjëhershëm - Kursen kohë dhe kosto - Mësuesi vlerëson të nxënësit nëpërmjet vëzhgimit - Përfshirje dhe motivim i shtuar nëpërmjet prezencës sociale	- Kërkesa për të qenë në të njëjtin vend në të njëjtën kohë - Mund të kërkojë aftësi të avancuara teknike dhe infrastrukturore - Cilësia e përfshirjes varet nga aftësia e mësuesit - Të mësuarit sipas ritmit të nxënësit nuk është fort e mundur
Asinkron	- Kurdo dhe kudo - Akses komod i materialeve dhe vlerësimit - Kohë për reflektim dhe eksplorim përpara se të përgjigjesh - Vlerësimi i mësuesit pas reflektimit - Detyra më të detajuara dhe më të thelluara	- Ndjesi izolimi e mundshme, humbje të lidhjeve njerëzore - Kërkon nivel të lartë vetëdrejtimi e motivimi - Cilësia e përfshirjes varet nga aftësia e mësuesit - Nuk ke akses të menjëhershëm tek mësuesi

Përdorimi i të nxënësve sinkron dhe asinkron

	Asinkron	Sinkron
Kur?	• Reflektimi mbi çështje komplekse • Kur mësimi sinkron nuk është i mundur të realizohet	• Diskutim mbi gjëra më të thjeshta • Njohje • Planifikimi për detyra
Pse?	• Nxënësit kanë më shumë kohë për të reflektuar	• Nxënësit janë më të përkushtuar dhe më të motivuar pasi u kërkohet përgjigja e menjëhershme
Si?	• Mjete asinkrone, si email, blogs, wikis	• Mjete sinkrone si videokonferenca, chat që plotësojnë takimet në klasë
Shembuj	- Nxënësve u kërkohet të reflektojnë dhe të bëjnë detyrat e shtëpisë - Nxënësit mund të vlerësojnë bashkëmoshatarët nëpërmjet një forumi diskutimi	- Mësuesi përgatit një video për ta përdorur në klasën e përmbysur.

Reflektim

- Cilat janë sfidat kryesore të veprimtarive mësimore sinkron online?
- Konsideroni ngjashmëritë dhe diferencat ndërmjet mësimimit në klasë dhe sinkron online. Në klasën tuaj si balanconi këto dy mundësi mësimore?
- Si arrini ju të krijoni një klimë të mirë në klasë? Në modelin e kombinuar?

